



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-060/01-0022390/25
12.06.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, nenit 27 të Rregullores të punës së Kuvendit, dhe në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 20.05.2025, në ora 10:00, në sallën e bordit të drejtoreve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
4. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit znj. Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë, mungon me arsye Alketa Mecini.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, në vlerë 194,930.63€, Të bartën ne kategoritë: Ne kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 92,002.99€, Në nën programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 shuma 40,000€, Ne nën-programin Arsimi parashkollor, shuma prej 30,000.00€. Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 22,002.99€. Ne kategorinë ekonomike Subvencione dhe transferove shuma prej 30,000.00€. Në nën-programin Planifikim i Zhvillimit Ekonomik 48023, shuma 30,000.00€. Ne kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej 72,927.64€. Në nën-programin Planifikimi mjedisor dhe inspekcioni 66620, projektin si vijon: "Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së" kodi i projektit 52641 shuma 72,927.64€, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim, Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;

-Të ndryshëm; e hap debatin nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për date ju njoftojmë përmes emaili, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit
